

LIGJ
Nr.10 168, datë 22.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG,
SHA-SË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i formës dhe i formulës së transferimit të aksioneve, që zotëron shteti shqiptar, në shoqërinë tregtare INSIG, sha dhe i të drejtave të lidhura me to.

Neni 2

Forma e privatizimit

1. Forma e transferimit të 100 për qind të aksioneve të shoqërisë tregtare INSIG, sha-së, të cilat zotërohen nga shteti shqiptar, është transferimi me anë të shitjes, në favor të investitorëve, nëpërmjet procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar”, sipas formulës së përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji.

2. “Investitor” është shoqëria e njohur në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të sigurimeve ose që ka partneritet me kompani që kanë përvojë në tregun e sigurimeve, që është e suksesshme në treg dhe është në gjendje të tregojë e të përmbushë kapacitetet e kërkuara për zhvillimin e INSIG, sha-së, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

3. Kriteret e përzgjedhjes së investitorëve dhe kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e INSIG, sha-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Formula e privatizimit

Struktura e formulës së privatizimit të INSIG, sha-së është që deri në 100 për qind të aksioneve t’u ofrohen për shitje investitorëve, të cilët përzgjidhen me tender të hapur ndërkombëtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Vlerësimi i çmimit dhe përzgjedhja e vlerësuesit

1. Vlera e të drejtave, që lidhen me aksionet e shtetit në INSIG, sha-në, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen, është vlera e miratuar me vendimin nr.1578, datë 4.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së të drejtave, që lidhen me aksionet e shtetit në INSIG, sha-në, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre”.

2. Nëse blerësit e mundshëm ofrojnë çmime blerjeje nën vlerën mesatare, negociohet me ofertuesit për rritjen e çmimit të ofruar. Kriteri i përzgjedhjes së blerësit/blerësve do të jetë çmimi, i cili:

a) nuk mund të jetë më i ulët se vlera mesatare, e përcaktuar në raportin e vlerësuesit ndërkombëtar;

b) duhet të jetë më i lartë nga ai i ofruar nga blerësit e kualifikuar në fazat e mëparshme të procesit të tenderit të hapur ndërkombëtar.

3. Projekt marrëveshja miratohet në Këshillin e Ministrave. Marrëveshja e shitjes së aksioneve të INSIG, sha-së nënshkruhet nga Ministri i Financave dhe përfaqësuesi i blerësit.

Neni 5

Kostoja e privatizimit

1. Shpenzimet e lidhura me pagesën e këshilltarit të privatizimit dhe ato të lidhura me suksesin e privatizimit përballohen nga arkëtimet, prej shitjes së aksioneve të INSIG, sha-së.

2. Shpenzimet e tjera, të nevojshme gjatë fazës së parë, përpara transferimit të aksioneve në favor të blerësit/blerësve, përballohen si pjesë e kostos operacionale të INSIG, sha-së.

Neni 6

Monedha e pagesës

Transferimi i aksioneve në favor të investitorëve të përzgjedhur, sipas këtij ligji, bëhet në një monedhë të huaj, sipas përcaktimit të bërë nga Ministri i Financave.

Neni 7

Aksionet e mbetura

Kur edhe pas përzgjedhjes dhe transferimit të aksioneve, sipas këtij ligji, kanë mbetur aksione të pashitura, ato u shiten, me ofertë publike, subjekteve private shqiptare brenda tre vjetëve nga data e transferimit të kësaj pjese të aksioneve.

Pagesa për shitjen e aksioneve subjekteve private shqiptare bëhet në monedhën vendase.

Neni 8

Detyrimet e investitorëve

1. Investitorët, pjesëmarrës në procesin e shitjes së aksioneve të INSIG, sha-së, duhet të respektojnë kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe ai i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

2. Investitorët e përzgjedhur sipas këtij ligji, për zotërimin e aksioneve të INSIG, sha-së, duhet të bien dakord, paraprakisht, për të miratuar çdo ndryshim të nevojshëm në statusin e kësaj shoqërie, për nënshkrimin e aksioneve të shoqërisë nga aksionerët e rinj, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Zbatimi i privatizimit

Ministria e Financave, në bashkëpunim me INSIG, sha-në, kryen procedurat e privatizimit të kësaj shoqërie, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 10

Nxjerrja e akteve

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 11

Shfuqizime

Ligji nr.9649, datë 27.11.2006 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha-së”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6319, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**